

# Parandaloni rëniet – Punoni me Masa Sigurie në Lartësi


## Puna në skelë

Rënia nga lartësia mund të çojë në vdekje ose aftësi të kufizuar të përhershme.

Për të gjithë vendet e punës ku ekziston rreziku i rënies, si p.sh. hapësira në dysheme, skajet e ndërtesave, hapësirat për vendosjen e ashensorëve, çatitë etj. është e nevojshme të zbatohen masat të përshtatshme kontrolli për të parandaluar rënien e punëtorëve, ose kur kjo nuk është e mundur, duhet të zbatohen masa për të zbutur pasojat e rënies.


Parandalimi i rënies mund të arrihet duke vendosur litarë të dyfishtë mbrojtës, mbulesa dyshemeje, rripa sigurie që i pengojnë lëvizjen e punëtorëve në skajet e ndërtesave (ose litarë) etj.

Zbutja e pasojave të rënies mund të arrihet duke përdorur rrjeta mbrojtëse, sisteme (jastëkë) për zbutjen e rënies, litarë mbrojtës dhe amortizues të energjisë që parandalojnë kontaktin e punëtorëve me objekte apo tokën (ndalues të rënies) etj.




Platforma e punës në skelë duhet të bëhet tërësisht me dërrasa. Platforma me gjerësi 600mm siguron qasje të sigurt dhe hapësirë të përshtatshme pune.


Gjatë montimit dhe çmontimit të skelës, punëtorët duhet të marrin masa për të parandaluar rënien, të tilla si litarë mbrojtës ose të punojnë me pajisje që parandalojnë rënien.



Puna në skelë




Platformat dhe skelat duhet të instalohen dhe kontrollohen nga ekspertë para përdorimit të tyre të parë, si dhe gjatë përdorimit të vazhdueshëm.




Vendosni 'Sloganin e fushatës' ose 'Një deklaratë të përgjithshme për sigurinë'

'Vendosni logot e organizatave të përfshira'



Në çdo nivel të skelës duhet të ketë qasje të sigurt. Shkallët e përdorura për t'u ngjitur në skelë duhet të jenë të sigurta në të dyja anët, për të parandaluar rrëshqitjen. Shkallët duhet të shtrihen të paktën 1 metër mbi nivelin e tokës për të siguruar mbajtjen e qëndrueshme.





Kur përdorni një skelë apo platformë të lëvizshme, duhet gjithmonë të siguroni (bllokoni) rrotat për të parandaluar lëvizjen e tyre aksidentale – dhe parrakët mbrojtës duhet të jenë në të njëjtin standard sikurse edhe skela.



KUJDES: Përveç inspektimit fillestar të sigurisë së skelës, kontrole të tilla duhet të bëhen gjithmonë kur bëhen modifikime, pas një periudhe mospërdorimi, ekspozimit ndaj motit të keq, efekteve sizmike, ose çdo gjëje që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ose stabilitetin e tyre, për të siguruar përdorimin e tyre.

Ekzaminimet mjekësore të punëtorëve duhet të jenë të detyrueshëm, në mënyrë që të përcaktojnë nëse punëtorët janë në gjendje të punojnë në lartësi.



**'Vendosni kontaktet e organizatave të përfshira'**